

**VENDIM**  
**Nr. 87, datë 6.2.2026**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 326, DATË 31.5.2023, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PAGAT E PUNONJËSVE MBËSHTETËS DHE PUNONJËSVE TË TJERË TË SPECIALITETEVE TË NDRYSHME NË DISA INSTITUCIONE TË ADMINISTRATËS PUBLIKE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjave “a” e “b”, të pikës 2, të nenit 8, të ligjit nr. 35/2023, “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Lidhjet nr. 1 dhe nr. 2, të vendimit nr. 326, datë 31.5.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike”, të ndryshuar, zëvendësohen me lidhjet me të njëjtët numra dhe tituj, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

2. Vlerat e elementit “paga bazë për klasë”, në lidhjet nr. 1 dhe nr. 2, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij, janë rezultat i indeksimit në masën 2.5% dhe i politikës së rritjes së pagave për punonjësit, pjesë e fushës së veprimit të këtij vendimi.

3. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi për vitin 2026, përballohen nga buxheti i institucioneve përkatëse, miratuar në ligjin nr. 87/2025, “Për buxhetin e vitit 2026”.

4. Ngarkohen institucionet, pjesë e fushës së veprimit të këtij vendimi, për zbatimin e tij.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 2026.

**KRYEMINISTËR**  
**Edi Rama**

**Lidhja I**

**Nivelet e pagës bazë për klasë të punonjësve të institucioneve të përmendura në shkronjën “a”, të pikës 1, të këtij vendimi**

<b>Nr. rendor</b>	<b>Klasa e pagës</b>	<b>Paga bazë për klasë</b>
1	I	50 000
2	II	51 000
3	III	51 800
4	IV	52 500
5	V	53 000
6	VI	54 000
7	VII	55 500
8	VIII	56 300
9	IX	57 000

**Lidhja II**

**Nivelet e pagës bazë për klasë të punonjësve të institucioneve të përmendura në shkronjën “b”, të pikës 1, të këtij vendimi**

<b>Nr. rendor</b>	<b>Klasa e pagës</b>	<b>Paga bazë për klasë</b>
1	I	50 000
2	II	51 000
3	III	51 800
4	IV	52 500
5	V	52 800
6	VI	53 200
7	VII	53 600
8	VIII	54 100
9	IX	54 800
10	X	55 300
11	XI	55 700
12	XII	56 000
13	XIII	56 700